



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 730 Akti

Nr. 787 Vendimi
Tiranë, më 23.7.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Valbona Sanxhaktari	Kryesuese
Alma Faskaj	Relatore
Pamela Qirko	Anëtare

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Albana Plaka, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, në datën 22.7.2024, ora 11:00, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, zhvilloi, seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Jonida Kondili**, me detyrë këshilltare ligjore në Gjykatën Kushtetuese.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8471, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisioneren Alma Faskaj, dëgjoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore, analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Subjekti i rivlerësimit, znj. Jonida Kondili, me detyrë këshilltare ligjore në Gjykatën Kushtetuese, i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 4 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 165¹ të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) në datën 15.6.2021 zhvilloi procedurat e shortit të shpërndarjes së çështjeve në trupa gjykues, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Alma Faskaj, Valbona Sanxhaktari dhe Pamela Qirko. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionerja Alma Faskaj.
4. Në mbledhjen e parë të trupit gjykues të datës 21.6.2021, me vendimin nr. 1, datë 21.6.2021, u caktua me mirëkuptim kryesuese komisionerja Valbona Sanxhaktari, si dhe u deklarua mospasja e asnjë konflikti interesi nga anëtarët e trupit gjykues. Trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016 për të tria kriteret, bazuar në pikën 1 të nenit 4 të po këtij ligji, përkatësisht: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale.
5. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV “Vlerësimi i pasurisë” të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të.
6. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte

¹ Dispozita kalimtare për ndihmësit ligjorë, këshilltarët e gjyqtarëve dhe inspektorët jomagjistratë: “1. Këshilltari i gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësi ligjor pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe në gjykatat administrative, si dhe inspektori në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, që nuk gëzon statusin e gjyqtarit ose prokurorit, janë subjekte të procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

7. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI të ligjit nr. 84/2016 dhe, veçanërisht në nenin 40 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

8. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK); Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).

9. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja dërgoi raportin e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

10. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (sot Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, AKSIK-ja ka dërguar raportin² e mbajtur për subjektin e rivlerësimit në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, znj. Jonida Kondili.

11. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe, në përfundim, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit³. Gjithashtu, Shkolla e Magjistraturës ka dërguar rezultatet e testimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit⁴, në kuptim të vlerësimit profesional të kryer, bazuar në nenin 42, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

12. Në vijim, janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara nga pika 5 e nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

² Raport mbi kontrollin e figurës nr.**** prot., datë 31.10.2017, për subjektin e rivlerësimit Jonida Kondili, të deklasifikuar plotësisht (me vendim të KDZH nr.*** datë 24.10.2023).

³ Raport për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Jonida Kondili, me nr.*** prot., datë 16.3.2023.

⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 23.5.2018.

13. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes dhe provat e grumbulluara për të tria kriteret: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe kriteri i aftësive profesionale, vlerësoi se ato arrijnë nivelin e provueshmërisë dhe, në vijim, në datën 12.7.2024, me vendimin nr. 2, datë 12.7.2024, vendosi: (i) përfundimin e hetimit paraprak për subjektin e rivlerësimit, bazuar në të tria kriteret; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35 - 40, 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 52 të ligjit nr. 84/2016. Afati brenda të cilit subjekti mund të ushtrojë të drejtat e tij lidhur me njohjen e dosjes së hetimit, paraqitjen e provave/shpjegimeve të tjera në vijim të rezultateve të hetimit, apo paraqitje të kërkesave të tjera, sipas të drejtave që gëzon nga ligji, u caktua data 18.7.2024.

14. Në vijim, në datën 18.7.2024, subjekti i rivlerësimit u njoh me materialet e dosjes së hetimit, duke administruar një kopje elektronike të saj, si dhe paraqiti pranë Komisionit shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, të shoqëruara me dokumentacionin⁵ provues.

15. Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti, trupi gjykues, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 3, datë 18.7.2024, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, znj. Jonida Kondili, në seancën dëgjimore të datës 22.7.2024, ora 11:00, duke e njoftuar nëpërmjet postës elektronike.

II. SEANCA DËGJIMORE

16. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, znj. Jonida Kondili, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 22.7.2024, ora 11:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova.

17. Subjekti i rivlerësimit, znj. Jonida Kondili, u paraqit personalisht në seancën dëgjimore, ku shprehu qëndrimin e saj lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe me procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni.

18. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

19. Znj. Jonida Kondili ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit ndaj saj, duke u përgjigjur dhe duke dërguar dokumentacionin dhe shpjegimet përkatëse sipas kërkesës së Komisionit, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar.

20. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, brenda afatit të kërkuar, duke qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT I KRYER NGA KOMISIONI

⁵ Shpjegimet në lidhje me rezultatet e hetimit, nr. *** prot., datë 18.7.2024.

21. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

21.1 Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese⁶ dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

21.2 Sa më sipër, bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI, së bashku me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e këtij subjekti; (d) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportet e kontrollit të figurës të dorëzuara pranë Komisionit nga AKSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar pranë Komisionit nga KLGJ-ja; (ë) verifikimin e denoncimeve nga publiku; (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në Komision apo nëpërmjet postës elektronike, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

22. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, Komisioni procedoi me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti.

23. Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, pavarësisht nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse, duke verifikuar deklaratën e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Jonida Kondili, sipas dokumentacionit të administruar gjatë hetimit.

24. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si dhe në burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

⁶ Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues, organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

25. Në deklaratën *Vetting*, të dorëzuar në ILDKPKI në datën 25.1.2017, pas verifikimit administrativ të kryer nga Komisioni ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar se zotërojnë këto pasuri dhe likuiditete:

26. Automjet tip “Volkswagen Polo”, në bashkëpronësi me babain L.GJ.K, sipas kontratës së shitblerjes nr. * rep., nr. *** kol., datë 30.3.2009. Vlera: 990,000 lekë⁷.**

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni

26.1 Komisioni hetoi lidhur me pasurinë e deklaruar, ku nga verifikimi i dokumentacionit të administruar rezultoi se pasuria automjet tip “Volkswagen Polo 9N”, me nr. shasie ***, me targë ***, nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës të vitit 2015 dhe as në DIPP-në e vitit 2015.

26.2 Subjekti i rivlerësimit e deklaroi për herë të parë pasurinë automjet në DIPP-në e vitit 2016, me të njëjtat të dhëna si në deklaratën e pasurisë *Vetting*.

26.3 DPSHTRR-ja⁸ konfirmon se automjeti tip “Volkswagen Polo” me targë *** është i regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit, e cila e ka mjetin në bashkëpronësi me të atin, shtetasin L.GJ.K. Bashkëlidhur përcillet dosja e automjetit, e cila përmban dokumentacionin e regjistrimit të mjetit, sipas kontratës noteriale të shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.3.2009.

26.4 Referuar kontratës, shitësi I.T, në cilësinë e pronarit të automjetit tip “Volkswagen Polo” me targë ***⁹, deklaroi shitjen e mjetit blerësve Jonida Kondili e L.K, kundrejt çmimit 990,000 lekë, shumë e cila është likuiduar jashtë zyrës noteriale.

26.5 Rezulton se automjeti është importuar nga vendi i origjinës, Gjermania, porositur nga shoqëria “C” sh.p.k., me adresë Rruga ***, Tiranë, në shumën 8,731 euro, si dhe shpenzime transporti 56,010 lekë, të parapaguara sipas faturës datë 11.11.2005. Mjeti ka kryer procedurat doganore në Portin e Durrësit, në datën 21.11.2005. Në vijim, sipas faturës tatimore nr. ***, datë 29.11.2005, automjeti është blerë nga shtetasi I.T, në vlerën totale 1,623,600 lekë.

26.6 Nëpërmjet verifikimit në sistemin online të AMF-së, konfirmohet policë sigurimi e automjetit në emër të shtetasit L.K nga data 10.12.2009 e në vijim, ndërsa subjekti i rivlerësimit rezultoi në sistem si përdorues i mjetit nga data 9.12.2011 deri më 8.12.2012. Më pas, nga data 10.12.2014 deri më 8.12.2020, subjekti i rivlerësimit rezultoi si pronar i mjetit.

26.7 Në përfundim ka rezultuar se përputhet deklarimi i subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ.

26.8 Lidhur me burimin e ligjshëm: Subjekti nuk deklaroi në deklaratën *Vetting* mbi burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e automjetit, por vetëm bashkëpronësinë me babain e saj për këtë pasuri. Referuar kohës në të cilën është krijuar pasuria, rezultoi se i përket periudhës përpara fillimit të detyrës nga subjekti i rivlerësimit, kohë në të cilën, sipas certifikatës familjare¹⁰, subjekti i rivlerësimit ka qenë në përbërjen familjare me prindërit e saj.

⁷ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën *Vetting*, aneks nr. 4/1 në dosjen e ILDKPKI-së, dokumentet: kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.3.2009, me palë blerëse L dhe Jonida Kondili, për automjetin me targë ***, me nr. shasie ***. Çmimi i kontratës 990,000 lekë; leje qarkullimi e automjetit nr. ***, datë 21.4.2009, për automjetin me targë ***, me nr. shasie ***; lëshuar për L dhe Jonida Kondili.

⁸ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 4.8.2021, në dosjen e hetimit.

⁹ Sipas lejes së qarkullimit nr. ***, datë 1.12.2005, pjesë e dosjes së DPSHTRR-së.

¹⁰ Certifikatë datë 8.7.2024, përcjellë nga subjekti me pyetësin nr. 2.

26.9 Duke qenë se kjo pasuri është krijuar brenda familjes, kur subjekti ishte në përbërje familjare së bashku me prindërit, me burim krijimi të ardhurat e përbashkëta të anëtarëve të familjes, Komisioni kreu analizën financiare mbi mundësinë e krijimit të pasurisë, duke marrë në konsideratë të ardhurat e subjektit dhe prindërve të saj, paraqitur si më poshtë:

Tabela nr. 1 (vlerat në lek)

Të ardhurat	Analiza kumulative 2005 – 30.3.2009
Të ardhura të subjektit të rivlerësimit pranë zyrës së avokatisë, llog. ProCredit Bank	48,000
Të ardhura të babait së subjektit të rivlerësimit nga paga ose pensioni pranë RBAL dhe ISSH	1,612,533
Të ardhura të nënës së subjektit të rivlerësimit nga paga pranë RBAL dhe BKT (2009)	1,394,564
Të ardhura të prindërve nga depozitat e kursimit	172,767
Të ardhura total	3,227,865
Shpenzime për pagesat e kredisë të marrë nga prindërit	1,209,149
Shtesa/pakësime likuiditete në bankë	(1,470,786)
Blerja e automjetit në bashkëpronësi me babain	990,000
Shpenzime udhëtimi	386,189
Shpenzime jetike (3 anëtarë)	1,579,527
Rezultati financiar	533,787

26.10 Nga analiza financiare rezultoi se subjekti dhe prindërit e saj kanë pasur mundësi të blejnë automjetin me të ardhura të ligjshme.

Vlerësimi i trupit gjykues

26.11 Në përfundim, trupi gjykues, në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit dhe deklarimeve të subjektit në seancë dëgjimore, çmon se për këtë pasuri nuk rezultojnë problematika në kuptim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

27. Të ardhurat nga momenti i fillimit të detyrës si këshilltare deri ditën e deklarimit.

Shuma: 931,681,852 lekë.

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni

27.1 Nga hetimi i kryer nga Komisioni rezulton se në deklaratën *Vetting* subjekti i rivlerësimit deklaron të ardhurat nga momenti i fillimit të detyrës si këshilltar ligjor deri ditën e deklarimit, sipas vërtetimit të bashkëlidhur, në shumën 931,681,852 lekë.

27.2 Gjithashtu, lidhur me këto të ardhura, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar ndër vite: (i) në DIPP-në para fillimit të detyrës, viti 2015, të ardhura nga paga si sekretare e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, në shumën 176,070 lekë; (ii) në DIPP-në e vitit 2015, paga si këshilltare e gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese, në shumën 807,816 lekë, si dhe të ardhura neto për barrë lindje, në shumën 168,002 lekë; (iii) në DIPP-në e vitit 2016, të ardhura nga detyra si këshilltar në Gjykatën Kushtetuese, në shumën 1,114,852 lekë.

27.3 Në lidhje me të ardhurat e subjektit të rivlerësimit, bashkëlidhen me deklaratën *Vetting*¹¹: (i) vërtetim page lëshuar nga Gjykata Kushtetuese për të ardhurat e znj. Jonida Kondili, për periudhën 24.9.2009 – 31.12.2016, në shumën 5,768,671 lekë; (ii) vërtetim page nr. *** prot.,

¹¹ Aneks nr. 4/2, në dosjen e ILDKPKI-së.

datë 7.1.2017, lëshuar nga Gjykata Kushtetuese për periudhën 1.1.2016 – 31.12.2016, në shumën 1,114,852 lekë.

27.4 Komisioni ka përfshirë në analizë të ardhurat e provuara me vërtetimet e institucioneve punëdhënëse, sa rezultat nga komunikimi me ISSH-në¹² dhe DPT-në¹³, duke i krahasuar me të ardhurat e transferuara në llogarinë e pagës së subjektit të rivlerësimit pranë Raiffeisen Bank.

Vlerësimi i trupit gjykues

27.5 Në përfundim, trupi gjykues vëren se, pavarësisht se vlera e të ardhurave nga paga në deklaratën *Vetting* është deklaruar e pasaktë, pasi është kryer analiza financiare e të ardhurave sipas dokumentacionit të përcjellë nga institucionet, ka rezultat se shumat përputhen me vlerën e vërtetimeve të Gjykatës Kushtetuese, paraqitur nga subjekti bashkëlidhur kësaj deklaratë.

28. Tërheqje *overdrafti* nga Raiffeisen Bank, Tiranë. Vlera: 170,000 lekë. Shumë e shlyer në datën 1.12.2016.

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni

28.1 Referuar dokumentacionit të administruar gjatë hetimit, Raiffeisen Bank¹⁴ konfirmon se në datën 1.10.2009 subjekti i rivlerësimit ka hapur llogari page pranë saj, në të cilën i janë transferuar të ardhurat nga paga gjatë periudhës së punësimit pranë Gjykatës Kushtetuese.

28.2 Duke u mbështetur në *statement*-in bankar të llogarisë së pagës, përcjellë nga Raiffeisen Bank, rezulton se subjekti ka pasur gjendje/balancë llogarie me vlerë negative, duke filluar prej datës 12.12.2014, e cila arrin vlerën maksimale të përdorimit prej -171,486 lekësh, ndërsa vlera *overdraft*-it e deklaruar prej saj është 170,000 lekë.

28.3 Në datën 30.11.2016, kur disbursohet kredia konsumatore/personale me vlerë 500,000 lekë e në vazhdim, balanca e llogarisë së subjektit kthehet në vlerë pozitive. Kjo situatë negative e krijuar me llogaritë bankare për periudha të gjata (si në rastin e subjektit prej gati 2 vjetësh) vjen kryesisht prej përdorimit të *overdarft*-eve, të cilat krijohen gjendje rezervë (limite të cilat mund të përdoren) në llogaritë e pagave.

Vlerësimi i trupit gjykues

28.4 Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë e në përputhje me dokumentacionin bankar, duke mos konstatuar problematika në lidhje me këtë pasuri, në kuptim të procesit të rivlerësimit.

29. Kredi personale e marrë në datën 30.11.2016 pranë Raiffeisen Bank (sipas kontratës bashkëlidhur). Shuma: 500,000 lekë.

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni

29.1 Subjekti i rivlerësimit deklaroi në DIPP-në e vitit 2016: “*Kredi personale në shumën 500,000 lekë, marrë në datën 30.11.2016 pranë Raiffeisen Bank, sipas kontratës së lidhur me këtë bankë, për një afat tre vjet*”.

¹² Shkresë nr. *** prot., datë 2.8.2021, e ISSH-së.

¹³ Shkresë nr. *** prot., datë 4.8.2021, e DPT-së.

¹⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 4.8.2021, e Raiffeisen Bank.

29.2 Raiffeisen Bank¹⁵ konfirmon se subjekti i rivlerësimit ka pasur një kredi pranë saj të marrë në datën 30.11.2016, në shumën 500,000 lekë, e cila është shlyer në datën 26.9.2018. Nga kopja e kontratës së kredisë bashkëlidhur përgjigjes së institucionit Komisioni informohet se subjekti ka përfituar një kredi konsumatore/personale, e cila pas disbursimit të saj në datën 30.11.2016 është tërhequr duke u përdorur nga subjekti në shuma të ndryshme gjatë një periudhe rreth 2-mujore (tërheqje në ATM, blerje me POS, pagesa e këstit të tretë të doktoraturës së saj etj.).

Vlerësimi i trupit gjykues

29.3 Sa më lart, trupi gjykues çmon se nuk u konstatuan problematika në lidhje me këtë pasuri, në kuptim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

A/1. DEKLARIMI I PASURIVE TË BASHKËSHORTIT TË SUBJEKTIT, Z. E.B

30. Apartament me sipërfaqe 78.10 m², ndodhur në rrugën “**”, kati 3, godina 7-kate, Tiranë, sipas kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.3.2012, lidhur pranë noterës M.SH. Vlera: 64,700 euro. Pjesa takuese: 100%.**

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni

30.1 Nga hetimi rezulton se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit deklaron në deklaratën *Vetting* kredinë bankare me të cilën është blerë pasuria apartament: “*Kredi e marrë së bashku me prindërit në degën e NBG Bank, Tiranë, në shumën 60,000 euro. Detyrimi i mbetur për t’u shlyer 35,252 euro*”.

30.2 Në DIPP-në para fillimit të detyrës, viti 2015, DIPP-në e vitit 2015, si dhe në DIPP-në e vitit 2016, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit deklaron pasurinë apartament, me të dhëna si ato të deklaruara në deklaratën *Vetting*: “*Vlera e pasurisë 64,700 euro, me pjesë takuese 100%*”.

30.3 Në deklaratimet ndër vite lidhur me kredinë e marrë, personi i lidhur deklaron: (i) në DIPP-në para fillimit të detyrës, viti 2015, kredi e marrë së bashku me prindërit në degën e NBG Bank, Tiranë, në shumën 60,000 euro, detyrimi për të shlyer 41,394 euro; (ii) në DIPP-në e vitit 2015, kredi e marrë së bashku me prindërit, shlyer nga deklarimi i mëparshëm shuma 3,246 euro dhe detyrimi i mbetur 38,324 euro; (iii) në DIPP-në e vitit 2016, personi i lidhur deklaron vetëm detyrimin e mbetur për shlyerjen e kredisë, në shumën 34,550.2 euro.

30.4 Në vijim, ASHK-ja¹⁶ konfirmon se në emër të shtetasit E.Q.B është regjistruar pasuria nr. ***, vol. ***, fq. ***, z. k. ***. Nga verifikimi i dokumentacionit kadastral të kësaj pasurie rezulton se sipas aktit noterial kontratë shitjeje pasurie të paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.3.2012, mes palëve, shitësit, shoqëria “W” sh.a. dhe blerësit E.B është dakordësuar shitja dhe njëkohësisht kalimi i pronësisë së pasurisë apartament nr. ***, me sip. 78.1 m², në katin e *** të godinës 7-katëshe, me nr. pasurie ***, në rrugën “****”, e regjistruar në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 25.11.2011, z. k. ***, Tiranë. Vlera e shitjes së pasurisë është deklaruar 64,700 euro, likuiduar nga ana e blerësit jashtë zyrës noteriale.

30.5 Referuar dokumenteve të vëna në dispozicion, rezulton se për regjistrimin e kësaj pasurie personi i lidhur E.B ka kryer pagesën e tarifave përkatëse pranë ZVRPP-së Tiranë në datën

¹⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 4.8.2021, e Raiffeisen Bank.

¹⁶ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 13.7.2023, ASHK Drejtoria Vendore Tirana ***, në dosjen e hetimit.

8.3.2012 dhe sipas vërtetimit nga dokumenti hipotekor nr. ***, datë 9.3.2012, pasuria nr. ***, e llojit apartament me sip. 78.1 m², rezulton e regjistruar në emër të shtetasit E.B.

30.6 Lidhur me pagesën e çmimit të blerjes së apartamentit

30.6.1 ABI Bank¹⁷ (e cila ka përthithur NBG Bank¹⁸) informon se shtetasi E.B është bashkëkredimarrës në kredinë hipotekore të marrë nga shtetasi Q.B, në shumën 60,000 euro. Nga *statementi* bankar rezulton se kredia është disbursuar në datën 18.11.2008 në llogarinë e shtetasit Q.B (NBG Bank nr. ***) dhe më pas shuma 59,460 euro është transferuar me përshkrimin “*Outward telex transfer*”. Gjithashtu, nga *statementi* rezulton se prej vitit 2016 depozitimi i shumës së pagesave për kredinë është kryer jo vetëm nga prindërit e bashkëshortit por edhe prej tij, shtetasit E.B. Ndërsa subjekti nuk rezulton të ketë bërë pagesa në llogari për kredinë.

30.6.2 Nga dokumentacioni bashkëlidhur përgjigjes së OTP Bank¹⁹ Komisioni informohet se shtetasi Q.B ka aplikuar në këtë bankë në vitin 2007 për kredi në vlerën 60,000 euro. Përcillet bashkëlidhur kontratë sipërmarrjeje datë 1.3.2007 lidhur midis shoqërisë “W” sh.a. dhe shtetasit Q.B, për blerje apartamenti me sipërfaqe bruto 86.3 m², kati i ***, me çmim blerjeje 90,700 euro. Ky çmim ishte parashikuar të shlyhej në kontratën e sipërmarrjes: (a) kësti i parë 39,000 euro me nënshkrimin e saj; (b) kësti i dytë me vlerë 41,700 euro deri më 1.9.2007; (c) kësti i tretë prej 10,000 euro paguhet në momentin e dorëzimit të apartamentit. Gjithashtu përcillet bashkëlidhur me kontratën e sipërmarrjes mandati bankar i BKT-së, ku shtetasi Q.B ka depozituar *cash* shumën 36,000 euro në llogarinë e shoqërisë “W” sh.a., në datën 1.3.2007 dhe mandatarkëtimi pranë shoqërisë për këtë pagesë të kryer pranë BKT-së.

30.6.3 Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime²⁰ dhe dokumentacion provues në lidhje me pagesat e kryera për këtë apartament, për të cilin ajo sqaron se: “Çmimi i banesës është 64,700 euro dhe është paguar me këto këste: (a) kësti i parë në vlerën 36,000 euro, në datën 1.3.2007; (b) kësti i dytë në vlerën 19,000 euro, në datën 17.9.2007; (c) kësti i tretë në vlerën 7,000 euro, në datën 16.2.2009; (ç) kësti i katërt në vlerën 2,700 euro, në datën 5.3.2012, pagesa e të cilit u përfshi në deklaratën e datës 5.3.2012, ku thuhet se palët nuk kanë asnjë detyrim të pashlyer ndaj njëri-tjetrit. Pagesa e çmimit prej 64,700 euro është pranuar edhe në kontratën e shitjes së datës 7.3.2012, të lidhur mes shoqërisë dhe shtetasit E.B. Në vijim të rrethanave të cituara, ju shpjegoj se në datën 1.3.2007, duke qenë se kushti i nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes ishte pagesa e këstit të parë, prindërit e bashkëshortit kanë paguar nga xhiroja e aktivitetit tregtar privat (bashkëlidhur ekstrakt nga QKB-ja) shumën prej 36,000 euro, që u kompensua me marrjen e kredisë. Në datën 14.9.2007, nga babai i bashkëshortit është tërhequr nga kredia shuma 25,000 euro, prej të cilave 19,000 euro ka paguar këstin e dytë. Në pagesën e këstit të tretë prej 7,000 euro, në datën 16.2.2009, shuma 5,000 euro është nga kredia, kurse 2,000 euro i kanë plotësuar nga të ardhurat e tyre. Deri në këtë moment ndaj firmës ishin shlyer shumat 36,000 euro, 19,000 euro dhe 7,000 euro, në total 62,000 euro. Nga çmimi i banesës mbeteshin edhe 2,700 euro, të cilat i janë dhënë firmës në datën 5.3.2012 dhe firma atë ditë i ka dhënë E.B, i cili lidhi edhe kontratën e shitblerjes, deklaratën se palët nuk kanë asnjë detyrim ndaj njëri-tjetrit. Për rrjedhojë, si rezultat i veprimeve të kryera, pagesa e çmimit të apartamentit në përfundim është 60,000 euro kredi dhe 4,700 euro nga të ardhurat e familjes”.

¹⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 4.8.2021, e ABI Bank.

¹⁸ Vërtetim për kredinë nr. ***, datë 24.10.2016, lëshuar nga NBG Bank. Aneks nr. 4/7 në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 29.7.2021, e OTP Bank.

²⁰ Pyetësor nr. 2, dërguar subjektit të rivlerësimit në rrugë elektronike në datën 5.7.2024.

30.6.4 Subjekti bashkëlidh me pyetësoin nr. 2²¹ aktin kontratë sipërmarrjeje datë 1.3.2007, lidhur midis shoqërisë “W” sh.a. dhe shtetasit Q.B, për blerje apartamenti me sipërfaqe bruto 86.3 m², kati i tretë, me çmim blerjeje 64,700 euro. Ky çmim ishte parashikuar të shlyhej në kontratën e sipërmarrjes: (a) kësti i parë prej 39,000 euro me nënshkrimin e saj; (b) kësti i dytë prej 22,000 euro deri në datën 1.9.2007; (c) kësti i tretë prej 3,000 euro paguhet në momentin e dorëzimit të apartamentit.

30.6.5 Përcillen gjithashtu edhe mandatpagesat për shlyerjen e kësteve të apartamentit, si vijon:

a) Kopje të mandatarkëtimit nr. ***, datë 1.3.2007, ku shtetasi Q.B shlyen shumën 36,000 euro për shoqërinë “W” sh.a. (sipas mandatit të BKT-së), kësti i parë blerje apartamenti;

b) Kopje të mandatarkëtimit nr. ***, datë 17.9.2007, ku shtetasi Q.B shlyen shumën 19,000 euro për shoqërinë “W” sh.a., me përshkrim kësti i dytë, për blerje apartamenti, shuma e derdhur në BKT, datë 14.9.2007. Subjekti përcjell kopje të *statement*-it të llogarisë së shtetasit Q.B në OTP Bank, nga e cila rezulton xhirimi i brendshëm midis llogarive të tij të shumës 25,000 euro, në datën 12.7.2007, e cila është mbajtur si depozitë kursimi deri në datën 14.9.2007 dhe më pas është tërhequr *cash* vlere e saj në datën 14.9.2007, me përshkrimin “Të ardhura nga biznesi, për blerje shtëpie”;

c) Kopje të mandatarkëtimit nr. ***, datë 16.2.2009, ku shtetasi Q.B shlyen shumën 7,000 euro për shoqërinë “W” sh.a., me përshkrimin “Për pagesën e kështit të apartamentit”.

30.6.6 Subjekti përcjell bashkëlidhur edhe një deklaratë (të thjeshtë), datë 5.3.2012, nënshkruar midis shtetasit E.B dhe shoqërisë “W” sh.a., ku palët deklarojnë se nuk kanë asnjë detyrim të pashlyer ndaj njeri-tjetrit, duke ia dorëzuar sendin (apartamentin) palës blerëse, si dhe plan amortizimi të kredisë në OTP Bank, në vlerën 60,000 euro, në emër të klientit Q.B, për shlyerje e kredisë për periudhën 12.8.2007 – 12.7.2022.

30.6.7 Më poshtë pasqyrohet pagesa e çmimit të apartamentit, sipas shpjegimeve dhe mandateve të përcjella nga subjekti i rivlerësimit sipas pyetësorit nr. 2:

Tabela nr. 2

	Data e pagesës	Vlera e kështit
K I	Datë 1.3.2007	36,000
K II	Datë 17.9.2007	19,000
K III	Datë 16.2.2009	7,000
K IV	Ddatë 5.3.2012	2,700
	Totali	64,700

30.7 FSHU-ja²² konfirmon se, referuar të dhënave të sistemit të faturimit, identifikohet një abonent me gjeneralitetet E.B, me nr. kontrate furnizimi ***, kontratë e çelur në datën 12.5.2008, ndryshuar emri nga Q.B në E.B në datë 4.12.2013, me adresë: rruga “****”, ***, ***, Tiranë.

30.8 UKT-ja²³ konfirmon se në emër të shtetasit E.B rezulton kontrata nr. ***, për objektin me adresë rruga “****”, Tiranë, me status “aktiv”, në kategorinë e konsumatorëve familjare. Nga verifikimi i dokumentacionit bashkëlidhur kontratës së furnizimit, vërtetim nga dokumenti

²¹ Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2, me shkresën nr. *** prot., datë 11.7.2024.

²² Shihni shkresën nr. *** prot., datë 2.8.2021 në dosjen e hetimit.

²³ Shkresë nr. *** prot., datë 12.8.2021.

hipotekor nr. ***, datë 9.3.2012, rezulton se ajo është lidhur për pasurinë nr. ***, ndodhur në z. k. ***, me sip. 78.10 m², rruga “****”.

30.9 Subjekti i rivlerësimit deklaroi në pyetësorin standard se në këtë banesë ka jetuar prej lidhjes së martesës, në muajit tetor 2013, dhe gjatë marrjes së detyrës, datë 16.3.2015, e në vijim, i cili është në pronësi të bashkëshortit të saj.

30.10 Nëpërmjet pyetësorit nr. 2, subjektit i është kërkuar të shpjegojë edhe arsyen e deklarimit në deklaratën *Vetting* nga bashkëshorti se apartamenti është fituar sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.3.2012, prej tij kundrejt çmimit 64,700 euro, ku rezulton se kjo pasuri është porositur nga prindërit e tij, shtetasit Q e M.B, kundrejt shumës 90,700 euro, të pasqyruar në kontratën e porosisë, nënshkruar në datën 1.3.2007, për të cilën subjekti sqaron: *“...po ju parashtroj veprimet e kryera nga prindërit e bashkëshortit në vitin 2007 për marrjen e kredisë, qëllimi i së cilës ka qenë blerja e apartamentit për birin e tyre. Në kushtet kur më kërkohet të jap shpjegime për veprime të kryera në një kohë dhe nga njerëz me të cilët unë, Jonida L. Kondili, nuk njihesha, duke përfshirë si bashkëshortin dhe prindërit e tij, bashkëlidhur shpjegimeve gjeni edhe një deklaratë noteriale të prindërve të bashkëshortit për veprimet e tyre, për të cilat nuk kam qenë në dijeni dhe më janë shpjeguar vetëm pas pyetjeve të dërguara nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Në mënyrë të përmbledhur po ju parashtroj si vijon: Prindërit e bashkëshortit në vitin 2007 janë interesuar pranë shoqërisë së ndërtimit “W” sh.a. për blerjen e një apartamenti për birin e tyre, për të cilin kanë rënë dakord, duke përcaktuar çmimin 64,700 euro. Në vijim janë interesuar pranë shoqërisë bankare “Banka Popullore” sh.a. për të filluar procedurat për marrjen e kredisë. Banka i ka sqaruar se djali nuk i plotësonte kushtet për marrjen e kredisë, kurse ata i plotësonin dhe se duhet të vinin garanci hipotekore pronat e tyre. Nga specialisti i bankës iu është thënë se mund të merrnin kredi me vlerën 60,000 euro, duke pasur parasysh vlerën e pronave që do të vendoseshin si garanci hipotekore për sigurimin e ekzekutimit të kredisë dhe që në një moment të dytë si garanci hipotekore do të vendosej apartamenti. Nisur nga vlera e pronave të tyre, në datën 1.3.2007 me shoqërinë është lidhur kontrata e sipërmarrjes me vlerën 90,700 euro, për bankën. Orientimet për kryerjen e veprimeve janë dhënë nga banka.*

Po në datën 1.3.2007 mes shoqërisë së ndërtimit dhe prindërve të bashkëshortit është lidhur kontrata e sipërmarrjes me vlerë 64,700 euro dhe me këtë vlerë janë paguar këstet, si dhe është lidhur kontrata e shitblerjes.

*Në datën 11.7.2007, mes prindërve të bashkëshortit dhe Bankës Popullore është lidhur kontrata e kredisë bankare, duke u vendosur si garanci hipotekore pronat e tyre, konkretisht apartamenti me sip. 64 m² i regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat me nr. pasurie ***, i ndodhur në zonën kadastrale ***, lagjja “****”, p. ***, shk. ***, kati ***, ap. ***, Berat dhe njësia me sipërfaqe 19.5 m² e regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat, zona kadastrale ***, lagjja “****”, Berat”.*

30.10.1 Subjekti me shpjegimet ka përcjellë kontratën e hipotekimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.3.2013, lidhur midis NBG Bank dhe hipotekuesve, shtetasit Q.B, M.B dhe E.B, për vendosjen si garanci hipotekore për pagimin e kredisë në vlerën 60,000 euro, të marrë në datën 24.10.2008, apartament me sip. 78.1 m², me nr. pasurie ***, vol. ***, fq. ***, z. k. ***, me adresë rruga “****”, Tiranë, sipas certifikatës për vërtetim pronësie, lëshuar në datën 15.3.2012.

30.10.2 Subjekti përcjell bashkëlidhur deklaratën noteriale nr. *** rep., nr.*** kol., datë 11.7.2024, ku prindërit e bashkëshortit deklarojnë se që në fillim qëllimi ka qenë blerja me

kredi e një banese për djalin. Përfaqësuesit e shoqërisë “W” sh.a., ku u interesuan, i informuan se pallati ishte ende në ndërtim, prandaj apartamenti nuk mund të hipotekohej në favor të bankës ku do të merrej kredi. Për shkak se kushtet për të marrë kredi i plotësonin prindërit dhe jo djali, kontrata e kredisë do të nënshkruhej me prindërit si kredimarrës, të cilët do të linin si garanci pronat e tyre. Në vijim, ata shprehen se me orientimin e bankës kanë nënshkruar kontratën e sipërmarrjes datë 1.3.2007, në vlerën 90,700 euro, duke pasur parasysh vlerën e kolateralit të vënë si garanci, i cili më vonë do të zëvendësohej nga apartamenti i blerë, objekt kredie. Ndërsa deklarojnë se po në atë ditë kanë firmosur edhe kontratën e sipërmarrjes datë 1.3.2007, me vlerë 64,700 euro, i cili është edhe çmimi real i blerjes së apartamentit prej tyre.

30.10.3 Gjithashtu, Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime me pyetësorin nr. 2 se si është realizuar nënshkrimi i kontratës së shitjes nga bashkëshorti i saj, kur kontrata e sipërmarrjes për këtë apartament ishte nënshkruar nga prindërit e tij, për të cilën sqaron: *“Kontrata e sipërmarrjes nuk është akt për fitimin e së drejtës së pronësisë. Prindërit e bashkëshortit prej fillimit, sikurse u parashtrua, kanë pasur si qëllim që apartamenti të blihej për të birin dhe për të realizuar qëllimin e tyre, në momentin kur kredia ka kaluar në NBG Bank (kontrata nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.10.2008), ka hyrë si kredimarrës edhe djali i tyre E.B. Firma ndërtuese ka regjistruar në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 25.11.2011, në pronësi të saj pasurinë me nr. ***, apartament i ndodhur në zonën kadastrale ***, rruga “****”, me sipërfaqe 78.10 m², në katin e tretë, godina 7-katëshe. Kontrata e shitblerjes është nënshkruar nga E.B, pasi qëllimi i prindërve ka qenë që pronësia të fitohej nga biri i tyre, të cilin e kanë shprehur prej fillimit te firma ndërtuese. Në datën 7.3.2012, mes shoqërisë ndërtuese dhe E.B është nënshkruar kontrata e shitblerjes së apartamentit. Në datën 15.3.2013, me kontratën e hipotekës nr. *** rep., nr. *** kol., të lidhur me NBG Bank si kolateral, ka kaluar vetëm apartamenti”.*

30.10.4 Në deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.7.2024, bashkëlidhur shpjegimeve, prindërit e bashkëshortit deklarojnë: *“Në muajin mars 2012, shoqëria ndërtuese “W” sh.p.k. kishte njoftuar përfundimin e ndërtimit të apartamentit dhe regjistrimin e pronësisë së ndërtesës në emër të saj, e në këto kushte mund të realizohej edhe kontrata përfundimtare e shitblerjes së apartamentit. Sikurse ishte dakordësuar që prej fillimit, me vullnetin tonë dhe miratimin e shoqërisë ndërtuese kontrata e shitblerjes u realizua përpara noterit vetëm në emër të djalit. Sqarojmë se, në kushtet që ne si prindër ishim në pamundësi financiare, të gjitha veprimet e kryera nga ana jonë kanë pasur si qëllim të vetëm sigurimin e një banese për djalin tonë”.*

30.11 Lidhur me çmimin e blerjes së apartamentit, sipas të dhënave të tregut të lirë të apartamenteve për qytetin e Tiranës²⁴, zona ***, rezulton se çmimi mesatar i shitblerjes së apartamenteve në tregun e lirë ka qenë 120,000 lekë/m².

Referuar sa më sipër²⁵, rezulton se pasuria (vlera e blerjes sipas kontratës së shitjes prej 64,700 euro ose 9,082,586 lekë) të jetë blerë rreth 0.3 herë më lirë sesa çmimi i referencës së EKB-së për shitjet e apartamenteve në Tiranë gjatë vitit 2012.

²⁴ Udhëzim i Këshilli i Ministrave nr. 4, datë 23.11.2011 “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banësive, për vitin 2011”.

²⁵ Pra, pasuria si më lart ka pasur vlerën 78.1 x 120,000 lekë = 9,372,000 lekë, ose i konvertuar në monedhën euro, 66,761 euro. Kursi mesatar në euro në mars të vitit 2012 ka qenë 140.38 https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Kursi_zyrtar_i_kembimit/Arkiva_e_kursit_të_kembimit/

30.12 Lidhur me burimin e krijimit të apartamentit, bashkëshorti nuk e deklaroi burimin e krijimit të tij në deklaratën Vetting.

30.12.1 Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime²⁶ në lidhje me mosdeklarimin e burimit të krijimit të apartamentit në deklaratën Vetting, për të cilën sqaron se: “Në deklaratën Vetting, të bërë në vitin 2017, në rubrikën “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, në përshkrimin e detyrimit është deklaruar kredia e marrë, që është burimi për blerjen e apartamentit, në vlerën 64,700 euro, sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.3.2012. Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie, nga ana e bashkëshortit është deklaruar kredia e marrë në NBG Bank, kur bashkëshorti hyri si kredimarrës (në fillim kredia është marrë nga prindërit pranë OTP-së dhe më pas ka kaluar në NBG Bank). Nga ana e tij është kuptuar se duhej të pasqyrohej burimi ndaj të cilit ai kishte detyrimin për ta shlyer, sikur edhe ka ndodhur nga momenti që ka hyrë si kredimarrës për të vazhduar deri në shlyerjen totale të kredisë në muajin nëntor të vitit 2023”.

30.12.2 Ndërsa nga informacioni i përcjellë nga ABI Bank²⁷ (e cila ka përthithur NBG Bank) dhe OTP Bank²⁸ rezultoi se prindërit e shtetasit E.B kishin përfituar në vitin 2008 një kredi bankare me qëllim blerje shtëpie. Në këtë kredi bashkëkredimarrës është edhe shtetasi E.B. Komisioni u mbështet në këtë informacion edhe në transfertën e kryer me fondet e kredisë në shumën 59,460 euro, për burimin e krijimit të çmimit të blerjes së apartamentit.

30.12.3 Ndërsa për pagesën e paradhënies prej 36,000 euro, kryer në mars të vitit 2007 nga shtetasi Q.B në llogarinë e shoqërisë “W” sh.a. (trajtuar më lart), Komisioni ka konsideruar në analizën e tij si burim të ardhurat e prindërve të bashkëshortit, të cilët rezultojnë të kenë aktivitet privat/tregtar të regjistruar prej vitit 1998. Konkretisht, shtetasja M.B (nëna e bashkëshortit) rezultoi të jetë regjistruar me vendimet nr. ***, datë 16.8.1999 dhe nr. ***, datë 12.7.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me aktivitet “Shitje artikujsh të ndryshëm industrialë” dhe “Bar-kafe”. Gjithashtu, shtetasi Q.B, babai i bashkëshortit, rezultoi i regjistruar me NIPT *** prej datës 16.8.1998, me objekt “Tregtim artikujsh të ndryshëm industrialë me pakicë”.

30.12.4 Më poshtë është paraqitur në mënyrë të përmbledhur tabela e burimeve të ligjshme për blerjen e tij:

Tabela nr. 3

Vlera e apartamentit	Burimi i krijimit	Shuma e burimit
64,700 euro sipas kontratës së sipërmarrjes datë 1.3.2007	Kredia pranë OTP Bank në korrik 2007 (shlyer prej kredisë së NBG Bank, në nëntor 2008)	60,000 euro
	Të ardhurat e familjes, nga të cilat shuma 2,000 euro shlyer në datën 16.2.2009 nga shtetasi Q.B me mandatpagesë dhe shuma 2,700 euro shlyer nga z. E.B sipas deklaratës datë 5.3.2012	2,000 euro të ardhurat e aktivitetit dhe kursime të prindërve deri në vitin 2009 2,700 euro të ardhura të z. E.B në periudhën 2011 – 5.3.2012

²⁶ Përgjigje e pyetësorit nr. 2, pyetja nr. 2.

²⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 4.8.2021, e ABI Bank.

²⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 29.7.2021, e OTP Bank.

30.13 Komisioni hartoi analizën financiare si më poshtë, për të hetuar mundësinë e shtetasit E.B për të shlyer pjesën e mbetur të çmimit të apartamentit në mars të vitit 2012, prej 2,700 euro, nga e cila rezultoi se ai kishte mundësi ta kryente këtë pagesë me të ardhura të ligjshme.

Tabela nr. 4 (Vlerat në lek)

Të ardhurat	2011	5.3.2012	Analiza kumulative 2011 – 5.3.2012
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	981,232	8,958	990,190
Shtesa/pakësime likuiditete në bankë	1,767	(2,306)	(539)
Shuma e pagesës së fundit për blerjen e apartamentit 2,700 euro, datë 5.3.2012	373,410	377,244	750,654
Shpenzime udhëtimi	62,235	-	62,235
Shpenzime jetike për një anëtar	136,620	23,258	159,878
Rezultati financiar	410,734	(393,850)	16,884

Vlerësimi i trupit gjykues

30.14 Në përfundim, trupi gjykues çmon se nga verifikimi i dokumentacioni të administruar gjatë hetimit rezultoi se pasuria është krijuar në vitin 2007 dhe ka filluar të përdoret që prej vitit 2008, pra përpara lidhjes së martesës së shtetasit E.B me subjektin e rivlerësimit, si dhe para fillimit të ushtrimit të detyrës nga subjekti. Personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, nuk e deklaroi burimin e krijimit të pasurisë apartament në deklaratën *Vetting*, por nga hetimi rezultoi i provuar burimi i krijimit të tij me të ardhura të ligjshme.

31. Automjet tip “Volkswagen Golf”, viti 1998, sipas kontratës së shitblerjes, duke përfshirë në vlerën e blerjes kostot e transportit, doganës. Vlera: 2,500 euro. Pjesa takuese: 100%.

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni

31.1 Në deklaratën *Vetting*, personi i lidhur deklaroi në pronësi të tij pasurinë automjet, në vlerën 2,500 euro, sipas kontratës së shitblerjes, duke përfshirë në vlerën e blerjes edhe kostot e transportit e doganës.

31.2 Nga deklaratimet ndër vite për këtë pasuri, rezultoi se në DIPP-në para fillimit të detyrës, viti 2015, DIPP-në e vitit 2015, si dhe në DIPP-në e vitit 2016, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit deklaroi pasurinë, me të dhëna si ato të deklaruara në deklaratën *Vetting*, në vlerën 2,500 euro dhe pjesë takuese 100%.

31.3 Komisioni hetoi lidhur me këtë pasuri, ku nga informacioni i përcjellë bëhet me dije se shtetasi E.Q.B ka të regjistruar në DPSHTRR²⁹ automjetin me targë ***.

31.4 Nga verifikimi i dokumentacionit në dosjen e automjetit, rezultoi se mjeti tip “Volkswagen Golf”, me numër shasie ***, vit prodhimi 1998, ka qenë në pronësi të shtetasit italian, M.L.³⁰.

31.5 Sipas aktit deklarati shiteje, datë 20.2.2013, shitësi M.L deklaroi se i ka shitur shtetasit E.B automjetin tip “Volkswagen”, në vlerën 1,000 euro. Referuar deklaratës doganore rezultoi

²⁹ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 4.8.2021, në dosjen e hetimit.

³⁰ Numri i certifikatës së pronësisë ***.

se automjeti është importuar nga shteti italian në datën 20.2.2013, në vlerën 1,000 euro, me kurs këmbimi 139.580, si dhe taksa doganore në vlerën 34,338 lekë.

31.6 Nga verifikim në sistemin e AMF-së³¹ rezulton se automjeti me targë ***, me pronar z. E.B, është pajisur rregullisht me policë nga data 21.2.2013 deri më 21.2.2022. Gjatë kësaj periudhe, subjekti i rivlerësimit rezulton i regjistruar si përdorues i mjetit për periudhën 21.2.2015 – 21.2.2019.

31.7 Komisioni kreu analizën financiare mbi mundësinë e blerjes së automjetit me të ardhura të ligjshme, duke marrë në konsideratë vlerën e deklaruar për blerjen e pasurisë prej 2,500 euro deri në datën 20.2.2013, pasqyruar në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 5 (Vlerat në lek)

Të ardhurat	Analiza kumulative 2012 – 20.2.2013
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	1,196,431
Të ardhura nga shitja e automjetit	90,000
Shtesa/pakësime likuiditete në bankë	729
Blerja e automjetit	350,525
Shuma e pagesës së fundit për blerjen e apartamentit 2,700 euro, datë 5.3.2012	377,244
Shpenzime për shlyerjen e kredisë pranë NBG Bank	373,719
Shpenzime udhëtimi	6,986
Shpenzime jetike për një anëtar	151,300
Rezultati financiar	25,928

31.8 Nga analiza financiare rezulton se bashkëshorti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të blerë automjetin me të ardhura nga burime të ligjshme, përpara lidhjes së martesës me subjektin e rivlerësimit.

Vlerësimi i trupit gjykues

31.9 Sa më lart, trupi gjykues vëren se pasuria është krijuar nga personi i lidhur me burime të ligjshme të ardhurash, përpara lidhjes së martesës me subjektin e rivlerësimit, si dhe përpara fillimit të detyrës nga subjekti, e se lidhur me të nuk konstatohen problematika, në kuptim të procesit të rivlerësimit.

32. Të ardhura neto si nëpunës pranë shoqërisë “A” sh.a. në pozicionin e * në departamentin IT, nga momenti i fillimit të detyrës sipas vërtetimit bashkëlidhur. Shuma: 292,700,262 lekë.**

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni

32.1 Lidhur me të ardhurat e deklaruara nga paga në funksionin si nëpunës pranë shoqërisë “A” sh.a., personi i lidhur ka deklaruar ndër vite: (i) në DIPP-në para fillimit të detyrës, viti 2015, të ardhura nga paga si nëpunës pranë shoqërisë “A” sh.a. në pozicionin e *** në departamentin IT, sipas pagës bruto 482,234 lekë/neto 379,731 lekë; (ii) në DIPP-në e vitit 2015, të ardhura nga i njëjti funksion, sipas pagës bruto në shumën 2,073,556 lekë dhe të ardhura nga paga neto në shumën 1,596,646 lekë; (iii) në DIPP-në e vitit 2016, të ardhura neto nga paga si nëpunës në shoqërinë “A” sh.a., në shumën 1,531,507 lekë.

³¹ AMF online dhe shkresa e AMF-së nr. ***, datë 11.8.2021.

32.2 Subjekti ka përcjellë bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, vërtetim page nr. *** prot., datë 20.10.2016, lëshuar nga A për të ardhurat e shtetasit E.B, ku rezulton se për periudhën 2008 – 2016 të ardhurat janë në shumën 9,477,471 lekë.

32.3 Komisioni ka përfshirë në analizën e tij të ardhurat e provuara me vërtetimet e institucioneve punëdhënëse, sa rezultuar nga komunikimi me ISSH-në³² dhe DPT-në³³, duke i krahasuar me të ardhurat e transferuara në llogarinë e pagës së subjektit të rivlerësimit pranë BKT-së³⁴.

32.4 Komisioni ka përfshirë në analizën financiare të ardhurat e vërtetuara nga institucionet, të cilat përputhen me vlerën e vërtetimit të A, përcjellë nga subjekti bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, ndërsa vlera e deklaruar nga bashkëshorti në këtë deklaratë rezulton e pasaktë.

Vlerësimi i trupit gjykues

32.5 Në përfundim, trupi gjykues çmon se nga verifikimi i dokumentacioni të administruar gjatë hetimit rezultoi se vlera e të ardhurave nga detyra për personin e lidhur përputhet me vlerën e pasqyruar në dokumentacionin e përcjellë prej tij bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, duke arritur në konkluzionin se pasaktësia e konstatuar nuk përbën relevancë për procesin e rivlerësimit, në kuptim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

33. Detyrim nga përdorimi i kartës së kreditit, në shumën 110,000 lekë

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni:

33.1 Në deklaratën e pasurisë *Vetting*, personi i lidhur deklaron detyrimin nga përdorimi i kartës së kreditit, në shumën 110,000 lekë.

33.2 Në DIPP-në para fillimit të detyrës, viti 2015, personi i lidhur deklaron detyrim nga përdorimi i kartës së kreditit, në vlerën 100,000 lekë. Në DIPP-në e vitit 2015 deklaron detyrim nga përdorimi i kartës së kreditit dhe gjendje e detyrimit të mbetur në shumën 122,000 lekë, ndërsa në DIPP-në e vitit 2016 gjendja e detyrimit të mbetur deklarohet në vlerën 106,149 lekë.

33.3 BKT-ja³⁵ informon se shtetasi E.B ka një kartë krediti pranë kësaj dege, me vlerë limiti 140,000 lekë e datë aprovimi 27.9.2010.

33.4 Rezulton se detyrimi i saj është shlyer nga të ardhurat nga paga e personit të lidhur, bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

Vlerësimi i trupit gjykues

33.5 Sa më lart, trupi gjykues çmon se, pas verifikimeve dhe analizës financiare të kryer, nuk janë konstatuar problematika në lidhje me detyrime/veprime financiare, në kudër të procesit të rivlerësimit kalimtar të subjektit.

34. Kontratë depozite “Fëmija im”, lidhur me Bankën Kombëtare Tregtare sipas kontratës bashkëlidhur nr. *, datë 10.1.2017**

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni

³² Shkresë nr. *** prot., datë 2.8.2021, e ISSH-së.

³³ Shkresë nr. *** prot., datë 4.8.2021, e DPT-së.

³⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 24.8.2021, e BKT-së.

³⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 24.8.2021, e BKT-së.

34.1 Nga verifikimi i deklaratës së pasurisë *Vetting* ka rezultuar se personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, në seksionin “Të dhëna konfidenciale” ka deklaruar kontratë depozite “Fëmija im”, lidhur me Bankën Kombëtare Tregtare sipas kontratës nr. ***, datë 10.1.2017, bashkëlidhur.

34.2 Referuar deklarimeve të mëparshme, rezulton se personi i lidhur ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2016³⁶, në rubrikën “Shpenzime të deklarueshme/Të dhëna konfidenciale”, kontratë depozite nr. ***, datë 10.1.2017, “Fëmija im”, lidhur në Bankën Kombëtare Tregtare, me shumë fillestare 1,200 lekë.

34.3 BKT-ja³⁷ informon se shtetasi E.B ka hapur depozitë kursimi “Fëmija im” në datën 10.1.2017 dhe ka depozituar *cash* shumën 12,000 lekë.

Vlerësimi i trupit gjykues

34.4 Sa më lart, lidhur me këtë deklaram, nuk u konstatuan problematika në lidhje me procesin e rivlerësimit të subjektit.

A/2. GJETJE TË TJERA

35. DPSHTRR-ja³⁸ informon se shtetasi E.Q.B ka pasur të regjistruar mjetin me targë ***.

35.1 Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se mjete është tip “Volkswagen 351 Passat”, viti prodhimi 1990, i cili sipas deklaratës datë 13.6.2002 të shtetasit italian S.C, pronar i mjetit³⁹, deklaron se ia ka shitur automjetin shtetasit L.T, me çmim 500 euro.

35.2 Sipas vërtetimit të zhdoganimit datë 10.7.2002, automjeti është importuar nga shtetasi L.T prej shtetit italian nëpërmjet Doganës Durrës, me vlerë 500 euro, me kurs këmbimi 138.74 dhe shpenzime doganore 156,930 lekë, në total 226,800 lekë.

35.3 Sipas aktit noterial “Kontratë shitjeje automjeti” me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.7.2002, shitësi L.T dakordëson shitjen e automjetit tip “Volkswagen 351 Passat”, me targë ***, blerësve Q.B dhe E.B, me çmim shitjeje 250,000 lekë.

35.4 Në vijim, në datën 14.7.2005, me kontratë shitjeje automjeti nr. ***, nga shtetasi Q.B është kryer përpara noterit shitja e pjesës së tij takuese të pronësisë mbi mjetin tip “Volkswagen Passat”, me targë ***, kundrejt çmimit 125,000 lekë, blerësit E.B, i cili bëhet pronari i vetëm i tij.

35.5 Sipas dokumentit të çregjistrimit në dosjen e mjetit, rezulton se automjeti ishte me targa ***, në pronësi të shtetasit L.T, i cili çregjistrohet dhe kalon në pronësi të shtetasit E.B, në datën 1.8.2005. Sipas lejes së qarkullimit rrugor datë 11.8.2005, pronar i mjetit rezulton shtetasi E.B.

35.6 Nga verifikimi në sistemin e AMF-së rezulton se automjeti me targë ***, me pronar E.B, është pajisur rregullisht me policë nga data 4.10.2008 deri më 31.12.2011. Ndërsa referuar targës ***, nga verifikimi në sistem rezultoi se nuk u gjet policë sigurimi.

³⁶ Dorëzuar në ILDKPKI në datën 29.3.2017.

³⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 24.8.2021, e BKT-së.

³⁸ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 4.8.2021, në dosjen e hetimit.

³⁹ Certifikatë pronësie nr. ***.

35.7 Sipas kontratës së shitblerjes⁴⁰ së automjetit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.11.2012, me palë shitëse shtetasin E.B dhe palë blerëse shtetasen M.S, rezulton se automjeti është shitur kundrejt çmimit 90,000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale.

35.8 Sa më lart, rezultoi se automjeti në pronësi të bashkëshortit është shitur përpara lidhjes së martesës ligjore me subjektin.

Vlerësimi i trupit gjykues

35.9 Në përfundim, trupi gjykues nuk konstatoi problematika apo *indicie* për hetime të mëtejshme, në kuadër të procesit të rivlerësimit.

36. Në emër të shtetasit Q.E.B, sipas informacionit të përcjellë nga ASHK/Drejtoria Vendore Tirana ***⁴¹, “Kartelë e pasurisë së paluajtshme”, rezulton se në datën 20.8.2013 figuron e regjistruar pasuria apartament nr. ***, me sipërfaqe 58.01 m², z. k. ***, vol. ***, fq. ***.

36.1 Nga dokumentacioni kadastral përcjellë bashkëlidhur rezulton se pasuria me të dhënat si më sipër është regjistruar në regjistrin hipotekor nr. ***, në datë 16.4.2003, në pronësi të shoqërisë “****”. Shtetasi Q.B e ka blerë pasurinë apartament 1+1, me adresë *** të Tiranës, në datën 23.7.2004, nga shitësi, shoqëria “****”, sipas kontratës së shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., me çmim 2,150,000 lekë, i cili është parashikuar të shlyhet deri në datën 10.4.2004.

36.2 ProCredit Bank⁴² (në atë kohë Fefad Bank) informon se blerja e këtij apartamenti është financuar pjesërisht nga kredia bankare pranë saj, dhënë sipas kontratës së kredisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.10.2001, në shumën 16,000 USD.

Vlerësimi i trupit gjykues

36.3 Në përfundim, për sa më sipër, trupi gjykues nuk konstatoi problematika në lidhje me procesin e rivlerësimit të subjektit.

37. ASHK/Drejtoria Vendore Korçë informon se⁴³:

37.1 Në emër të shtetasve L.GJ.K dhe V.R.K figuron pasuria e llojit apartament 2+1, me nr. ***, me sipërfaqe totale 73.5 m², në z. k. ***, Korçë, përfutuar nëpërmjet kontratës për privatizimin e banesës datë 13.4.1993. Me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.5.1999, bashkëpronarët Kondili e kanë tjetërsuar pasurinë e sipërcituar nëpërmjet shitjes te shtetasi N.E.L, kundrejt çmimit 2,000,000 lekë, shlyer jashtë zyrës noteriale.

Vlerësimi i trupit gjykues

37.2 Sa më sipër, lidhur me këtë pasuri, trupi gjykues nuk konstatoi problematika në lidhje me procesin e rivlerësimit të subjektit.

38. Në emër të shtetasve V.R.K, nëpërmjet trashëgimisë ligjore⁴⁴ pas vdekjes së të atit është përfutuar pjesë takuese në pasurinë e llojit apartament nr. ***, me sipërfaqe 61.5 m², ndodhur në z. k. ***, rruga “****”, Korçë. Në origjinë, pasuria është përfutuar sipas kontratës për privatizimin e banesës datë 10.5.1983, lidhur nga NK Banesa dhe qiramarrësit R.N.

Vlerësimi i trupit gjykues

⁴⁰ Kopje kontrate në dosjen e ILDKPKI-së (aneks nr. 35) dhe bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2.

⁴¹ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 13.9.2023, ASHK/Drejtoria Vendore Tirana ***, në dosjen e hetimit.

⁴² Shkresë nr. *** prot., datë 6.8.2021, e ProCredit Bank.

⁴³ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 28.8.2023, në dosjen e hetimit.

⁴⁴ Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë nr. ***, datë 18.7.2008 “Lëshim i dëshmisë së trashëgimisë ligjore të R.N.N”.

38.1 Sa më sipër, lidhur me këtë pasuri, trupi gjykues nuk konstatoi problematika në lidhje me procesin e rivlerësimit të subjektit.

39. Në emër të shtetasit L.GJ.K, me lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.2.2018, pas vdekjes së të atit, është përfituar pjesë takuese në pasurinë nr. ***, ndodhur në z. k. ***, V, Korçë. Pasuria nr. *** është e llojit pemëtoare, me sipërfaqe totale 827 m², regjistruar në emër të shtetasit GJ.L.K sipas certifikatës për vërtetim pronësie nr. ***, datë 13.12.2016. Pasuria nr. *** është pjesë e pasurisë nr. ***, përfituar në origjinë me AMTP-në nr. ***, prej 880 m² në total, e llojit pemëtoare, e cila është ndarë në dy pasuri, nr. *** dhe nr. ***.

Vlerësimi i trupit gjykues

39.1 Sa më sipër, lidhur me këtë pasuri, trupi gjykues nuk konstatoi problematika në lidhje me procesin e rivlerësimit të subjektit.

40. ASHK/Drejtoria Vendore Berat informon se⁴⁵:

40.1 Në pronësi të shtetasit Q.E.B figuron e regjistruar pasuria nr. ***, vol. ***, fq. ***, e llojit njësi, me sipërfaqe totale 19.5 m², ndodhur në z. k. ***, Berat. Referuar kartelës së pasurisë së paluajtshme, pasuria është regjistruar në pronësi të shtetasit Q.B në datën 2.5.2002. Pasuria është përfituar sipas kontratës së shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. ***, datë 13.5.1996, me palë shitëse J e V.S, të cilët i shesin blerësit Q.B pasurinë dyqan, me sipërfaqe të përgjithshme 23.4 m², në vlerën 1,100,000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale. Rezulton se në origjinë prona është përfituar nga shtetasi M.K, sipas vendimit nr. ***, datë 16.2.1994, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të Bashkisë Berat.

Vlerësimi i trupit gjykues

40.2 Sa më sipër, lidhur me këtë pasuri, trupi gjykues nuk konstatoi problematika në lidhje me procesin e rivlerësimit të subjektit.

41. Në pronësi të shtetasës M.H.B figuron e regjistruar pasuria nr. ***, vol. ***, fq. ***, e llojit ndërtesë, me sipërfaqe totale 22 m², ndodhur në z. k. ***, Berat. Sipas kartelës së pasurisë së paluajtshme rezulton se pasuria është regjistruar në datën 3.2.2011, me pronar M.B, përfituar nëpërmjet lejes së ndërtimit për shtesë lokali, të miratuar me vendimin nr. ***, datë 21.4.1999, të KRRT-së, Bashkia Berat.

Vlerësimi i trupit gjykues

41.1 Sa më sipër, lidhur me këtë pasuri, trupi gjykues nuk konstatoi problematika në lidhje me procesin e rivlerësimit të subjektit.

42. Në pronësi të shtetasës M.H.B figuron e regjistruar pasuria nr. ***, vol. ***, fq. ***, e llojit njësi, me sipërfaqe totale 18 m², ndodhur në z. k. ***, Berat. Referuar kartelës së pasurisë së paluajtshme, rezulton se pasuria është regjistruar në datën 23.7.2010, me pronar M.B. Referuar akteve, rezulton se shtetasit M.B, A.A dhe A.D janë bashkëpronarë të një dyqani me sip. 48 m², me pjesë takuese 1/3 secila. nëpërmjet kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.9.1993, shitësit A.D dhe A.A kanë shitur pjesët e tyre takuese prej 2/3, me çmim 180,000 lekë secila, blerëses M.B, duke e bërë pronare të vetme të pasurisë. Në datën 30.1.1995, me kontratën nr. *** “Për shitjen e pasurisë së paluajtshme”, pala shitëse, Seksioni i Financës së Rrethit Berat,

⁴⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 23.8.2023, e ASHK Berat.

i ka shitur blerëses M.B një sipërfaqe trualli prej 48 m², në pronësi të shtetit, mbi të cilën është i ndërtuar një dyqan i cili është i regjistruar në pronësi të blerëses M.B, me nr. pasurie ***, vol. ***, datë 6.10.1993. Kjo sipërfaqe trualli prej 48 m² i është shitur blerësit kundrejt çmimit 12,960 lekë. Sipas të dhënave, kjo pasuri është regjistruar në regjistrin e transkriptimeve hipotekore nr. ***, vol. ***, datë 5.10.1995. Në vijim, sipas deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.7.2010, shtetasja M.B ka deklaruar se ka në pronësi një pasuri të llojit njësi të regjistruar në zyrën e hipotekës Berat në vol. ***, nr. ***, datë 6.10.1993. Kësaj njësie, sipas kontratës nr. ***, i është blerë edhe trualli me sip. 18 m², reregjistruar së bashku me dyqanin në vol. ***, me nr. pasurie ***, datë 20.2.1998. Këtë pronë deklaruesja kërkon ta reregjistrojë në ZVRPP-në Berat aq sa e ka blerë faktikisht, 18 m².

Vlerësimi i trupit gjykues

42.1 Sa më sipër, lidhur me këtë pasuri, trupi gjykues nuk konstatoi problematika në lidhje me procesin e rivlerësimit të subjektit.

A/3. ANALIZA FINANCIARE (për periudhën mars 2015 – 2016)

43. Lidhur me pasuritë e krijuara, shpenzimet dhe kursimet e deklaruara, u verifikuan dhe u krahasuan përputhshmëria e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave pasurorë privatë/vjetorë, deklaratën *Vetting*, si dhe aktet e tjera në dosjen e Komisionit.

44. Në konkludim të sa më sipër, Komisioni hartoi analizën financiare të subjektit të rivlerësimit për periudhën qershor 2015 – 2016, mbi mundësinë financiare të krijimit të pasurive apo likuiditeteve, e cila për këtë periudhë rezultoi me balancë pozitive e me burime të ligjshme krijimi.

Konkluzion për rubrikën e vlerësimit të pasurisë

45. Në përfundim, në lidhje me rubrikën e vlerësimit të pasurisë, trupi gjykues arrin në përfundimin se nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit, nuk u evidentuan pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, se ai ka kryer deklaram që është i saktë dhe në përputhje me ligjin dhe se ka pasur burime financiare të ligjshme e të mjaftueshme. Pasuria e subjektit të rivlerësimit dhe e personave të lidhur rezulton të jetë e ligjshme, nuk ka deklarim të rremë apo të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë. Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit interesi.

ANALIZA FINANCIARE

<i>Përshkrimi</i>	Para marrjes së detyrës	16.03.2015-31.12.2015	2016
PASURI	8,081,013	(37,964)	204,761
Makinë Volkswagen Polo, bashkëpronësi me babain, sipas kontratës së shitblerjes dt.30.03.2009 lidhur pranë noteres. Vlera 990,000 lekë	990,000		
Apartament, sipërfaqe 78.10 m2, ndodhur në Rr. “*****”, Tiranë, sipas kontratës së shitblerjes, datë 7.3.2012. Vlera 64,700 euro. Zotërimi 100%.	9,071,587		
Automjet tip Volkswagen Golf, në pronësi të bashkëshortit, sipas kontratës së shitblerjes datë 20.02.2013, duke përfshirë kostot e transportit, doganës, vlera 2,500 euro.	350,525		
Shtesa/pakësime likuiditete në bankë dhe CASH	(2,331,099)	(37,964)	204,761
<i>Total likuiditete</i>	<i>(150,888)</i>	<i>(188,853)</i>	<i>15,909</i>
DETYRIME	0	0	500,000
Kredi konsumatore marrë prej subjektit të rivlerësimit pranë RBAL			500,000
PASURI NETO	8,081,013	(37,964)	(295,239)
TË ARDHURA të dokumentuara	17,885,241	2,137,441	2,646,359
Të ardhura të subjektit të rivlerësimit pranë zyrës së avokatisë llog. Procredit bank	48,000		
Të ardhura të përfituara nga subjekti pranë Gjykatës Kushtetuese përpara periudhës së rivlerësimit	3,861,155		
Të ardhura të përfituara nga subjekti pranë Gjykatës Kushtetuese gjatë periudhës së rivlerësimit	0	792,664	1,114,852
Të ardhura të babait së subjektit të rivlerësimit nga paga dhe pensioni	1,545,605		
Të ardhura të nënës së subjektit të rivlerësimit nga paga	1,028,304		
Të ardhura të prindërve nga depozitat e kursimit	146,307		
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	1,923,255	1,344,777	1,531,507
Të ardhura të bashkëshortit të fituara para martesës ligjore (Rregullim zëri për efekt të analizës financiare)	9,332,615		
SHPENZIME	7,936,183	1,217,931	2,008,069
Shpenzime për pagesat e kredisë të marrë nga prindërit e subjektit	1,920,470		
Shpenzime për pagesat e kartës së kreditit të bashkëshortit në BKT	174,928	364,210	469,380
Shpenzim nga shkëputja e subjektit prej prindërve dhe lidhjes së martesës ligjore (Rregullim zëri për efekt të analizës financiare)	6,308		
Shpenzime mobilimi deklaruar në pyetësor nr. 1	710,000		
Shpenzime për pagesat e kredisë për apartamentin marrë pranë ABI bank (NBG bank)	660,937	389,660	563,919
Shpenzim për pagesën e tarifës së Doktoratës	5,000		72,000
Shpenzime udhëtimi	1,069,336	71,578	197,494
Shpenzime jetike	3,389,204	392,483	705,276
Analiza dokumentuar	1,868,044	957,474	933,528

B. KONTROLLI I FIGURËS

46. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Në përfundim, ky institucion, në datën 31.10.2017, ka dërguar raportin mbi kontrollin e figurës⁴⁶ për subjektin e rivlerësimit Jonida L. Kondili, duke konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e ushtrimit të detyrës.

47. Komisioni i ka kërkuar institucioneve ligjzbatuese sipas ligjit për ditësim të informacionit mbi të dhëna shtesë për subjektin e rivlerësimit Jonida L. Kondili, për sa kohë që raporti mbi kontrollin e figurës ishte deri më 31.10.2017. Nga verifikimet nuk kanë rezultuar të dhëna për hetime të mëtejshme.

48. Komisioni i ka kërkuar AKSIK-së deklasifikimin e raportit për vlerësimin e figurës për subjektin e rivlerësimit Jonida L. Kondili, i cili, në vijim, ka përcjellë raportin mbi kontrollin e figurës për këtë subjekt rivlerësim, të deklasifikuar plotësisht⁴⁷, duke konstatuar se: (i) formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) për subjektin e rivlerësimit Jonida Kondili nuk administrohen prova, informacione konfindenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar; (iii) përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës.

49. Gjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioni nuk konstatoi asnjë problematikë lidhur me pastërtinë e figurës për subjektin e rivlerësimit Jonida L. Kondili.

Konkluzion për rubrikën e vlerësimit të figurës

50. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar prej subjektit të rivlerësimit, deklaratën për kontrollin e figurës, raportin e AKSIK-së dhe informacionet nga organet ligjzbatuese, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Nuk u provua që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose që të jetë i përfshirë apo i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë, e gjen atë të përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

51. Vlerësimi i aftësive profesionale të këshilltarit ligjor pranë Gjykatës Kushtetuese kryhet në përputhje me parashikimin e nenit 42, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, si dhe bazuar edhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

⁴⁶ Raportin mbi kontrollin e figurës nr. *** prot., datë 31.10.2017, për subjektin e rivlerësimit Jonida Kondili, të deklasifikuar plotësisht (me vendim të KDZH-së nr. *** datë 24.10.2023).

⁴⁷ Përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 31.10.2023, të AKSIK-së.

52. Në nenin 42, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: “Këshilltari ligjor i Gjykatës Kushtetuese, ndihmësi ligjor i Gjykatës së Lartë, Gjykatës Administrative, si dhe ndihmësi ligjor në Prokurorinë e Përgjithshme, të cilët nuk janë magjistratë, vlerësohen bazuar në: a) relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura; dhe b) rezultatet e testimit pranë Shkollës së Magjistraturës”.

53. Lidhur me kriterin e parë vlerësues, relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura, Komisioni i ka kërkuar Këshillit të Lartë Gjyqësor informacion mbi vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit, për periudhën 8.3.2015 – 8.10.2016.

54. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka përcjellë në Komision raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Jonida Kondili, me nr. *** prot., datë 16.3.2023, si dhe dokumentacionin shoqërues bashkëlidhur tij.

55. Raporti i përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit: (a) aftësive profesionale; (b) aftësive organizative; (c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; (ç) aftësive personale dhe angazhimit profesional.

56. Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëvlerësimit; (ii) 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëvlerësimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; (iii) 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iv) të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.

57. Pavarësisht raportit të hartuar nga KLGJ-ja, Komisioni kreu një hetim të pavarur në lidhje me analizimin e tri dokumenteve të përzgjedhura nga subjekti dhe pesë dosjeve të shortuara sipas një shorti objektiv. Pas analizimit të tyre, si dhe duke marrë në konsideratë shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues nuk konstatoi problematika të cilat lidhen me vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit Jonida Kondili, në cilësinë e këshilltarit ligjor pranë Gjykatës Kushtetuese.

TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE (Ankesa, masa disiplinore dhe vlerësime)

58. Nga verifikimi i kryer rezultoi se pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor nuk disponohen të dhëna nga burimet arkivore mbi etikën e këshilltares ligjore Jonida Kondili. Gjithashtu, sipas të dhënave të Gjykatës Kushtetuese⁴⁸, është konfirmuar se për subjektin e rivlerësimit Jonida Kondili, në ushtrimin e funksionit të saj si këshilltare ligjore pranë Gjykatës Kushtetuese, nga emërimi i saj e në vijim nuk është kryer asnjë shkelje e etikës dhe nuk është dhënë masë disiplinore.

TË DHËNA NGA PROKURORITË

59. Prokuroria e Përgjithshme⁴⁹ ka përcjellë në Komision përgjigjet e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm⁵⁰, që konfirmojnë se pranë tyre

⁴⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 8.3.2023.

⁴⁹ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2021, të Prokurorisë së Përgjithshme, në dosjen e hetimit.

⁵⁰ Shihni shkresat kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 2.11.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; nr. *** prot., datë 30.9.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë; nr. *** prot., datë 17.9.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; nr. *** prot., datë 16.9.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; nr. *** prot., datë 13.9.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës; nr. *** prot., datë 13.9.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; nr. *** prot., datë 13.9.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë; nr. *** prot., datë 13.9.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. *** prot., datë 10.9.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë; nr. *** prot., datë 10.9.2021, të Prokurorisë

nuk rezulton të ketë procedime penale të mosfilluara/pushuara/pezulluara apo të dërguara për gjykim për subjektin e rivlerësimit Jonida L. Kondili.

60. Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar⁵¹ konfirmon se pas verifikimeve të kryera në regjistrin e njoftimit të veprave penale nuk rezulton që të jetë regjistruar ndonjë procedim penal në emër të shtetases Jonida L. Kondili.

REZULTATET E TESTIMIT PRANË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS

61. Lidhur me kriterin e dytë vlerësues, rezultatet e testimit pranë Shkollës së Magjistraturës, pranë Komisionit janë përcjellë⁵² rezultatet e testimit të aftësive profesionale për subjektet e rivlerësimit *ex officio*, të parashikuara në pikën 4 të nenit 179/b⁵³ të Kushtetutës dhe pikën 2 të nenit 42⁵⁴ të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

62. Në testimin profesional të organizuar në Shkollën e Magjistraturës, sipas listave bashkëlidhur vendimit nr. ***, datë 21.5.2018, të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës dhe të shpallura nga Komisioni i Mbikëqyrjes së Vlerësimit Elektronik (faza e parë) dhe Komisioni i Vlerësimit të Testit Profesional (faza e dytë), rezulton se këshilltarja ligjore e Gjykatës Kushtetuese, znj. Jonida Kondili, është vlerësuar në fazën e parë me 51 (pesëdhjetë e një) pikë nga 100 pikë maksimale dhe në fazën e dytë me 93 (nëntëdhjetë e tre) pikë nga 200 pikë maksimale, vlerësuar në total me 144 pikë.

63. Bazuar në parashikimet e nenit 165/4 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, subjekti i rivlerësimit nuk bën pjesë të subjektet që kanë fituar të paktën 60% të pikëve të testimit të aftësive profesionale e, për pasojë, nuk është kualifikuar për të ndjekur formimin fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës.

64. Duke qenë se testimi pranë Shkollës së Magjistraturës është në vetvete një nga kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit *ex officio*, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit është vlerësuar në këtë testim me një rezultat nën pragun prej 60% të pikëve, rezultat i cili nuk e ka penguar subjektin e rivlerësimit për vijimin e ushtrimit të detyrës.

DENONCIME/ANKESA NGA PUBLIKU

65. Nga verifikimi i regjistrin të denoncimeve nuk rezulton që të jenë depozituar pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit ankesa apo denoncime nga publiku për subjektin e rivlerësimit Jonida Kondili, në kuptim të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; nr. *** prot., datë 9.9.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë; nr. *** prot., datë 7.9.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat; nr. *** prot., datë 7.9.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë; nr. *** prot., datë 7.9.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë; nr. *** prot., datë 18.8.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat; nr. *** prot., datë 9.8.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; nr. *** prot., datë 9.8.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin; nr. *** prot., datë 6.8.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë; nr. *** prot., datë 6.8.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec; nr. *** prot., datë 5.8.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë; nr. *** prot., datë 5.8.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

⁵¹ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 13.8.2021, të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

⁵² Shihni shkresën nr. *** prot., datë 23.5.2018.

⁵³ Të gjithë këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësit ligjorë pranë gjykatave administrative, ndihmësit ligjorë pranë Prokurorisë të Përgjithshme do të rivlerësohen *ex officio*.

⁵⁴ *Këshilltari ligjor i Gjykatës Kushtetuese, ndihmësi ligjor i Gjykatës së Lartë, Gjykatës Administrative, si dhe ndihmësi ligjor në Prokurorinë e Përgjithshme, të cilët nuk janë magjistratë, vlerësohen bazuar në: a) relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura; b) rezultatet e testimit pranë Shkollës së Magjistraturës.*

Konkluzion për rubrikën e vlerësimit të aftësive profesionale

66. Bazuar në ligjin nr. 84/2016, duke qenë se dokumentet ligjore të analizuara dhe testimi pranë Shkollës së Magjistraturës, së bashku shërbejnë në mënyrë kumulative për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, nga analiza në tërësi e kriterit të aftësive profesionale, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në ushtrimin e detyrës, duke shfaqur eficiencë e profesionalizëm të një niveli kualifikues, kërkuar nga parashikimi i nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, për vlerësimin e aftësive profesionale.

67. Në përmbushje të parashikimit të shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në zbatim të nenit 59, pika 1, shkronja “c”, trupi gjykues e konsideron subjektin e rivlerësimit “të aftë” në kryerjen e funksionit të këshilltarit ligjor pranë Gjykatës Kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe pikën 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel kualifikues të vlerësimit të aftësive profesionale,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Jonida Kondili, këshilltare ligjore në Gjykatën Kushtetuese.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 23.7.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Valbona SANXHAKTARI
Kryesuese

Alma FASKAJ
Relatore

Pamela QIRKO
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Albana Plaka